

VENDIM
Nr. 140, data 4.4.2022

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË
PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU TIRANË, Z. PANDELI SOTIR
MAJKO**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2; 163, pika 7; 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1274/8 prot., datë 31.3.2022, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes, të z. Alqi Edmond Bllako, i zgjedhur deputet në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021. Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, janë:

numri rendor 01 (një) znj. Luljeta Vasil Bozo, numri rendor 02 (dy) znj. Najada Fatosh Çomo, numri rendor 03 (tre) z. Orinaldo Aqif Rakipi, numri rendor 04 (katër) znj. Ogerta Dhionis Manastirliu, numri rendor 05 (pesë) z. Arben Nevruz Ahmetaj, numri rendor 06 (gjashtë) z. Ulsi Qerim Manja, numri rendor 07 (shtatë) znj. Etilda Dalip Gjonaj, numri rendor 08 (tetë) z. Arben Servet Pëllumbi, numri rendor 09 (nëntë) znj. Elisa Aleksander Spiropali, numri rendor 10 (dhjetë) znj. Belinda Çlirim Balluku, numri rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Toni Jorgaq Gogu, numri rendor 12 (dymbëdhjetë) z. Etjen Vullnet Xhafaj, numri rendor 13 (trembëdhjetë) znj. Ermonela Koço Valikaj, numri rendor 14 (katërmëdhjetë) z. Xhemal Myslym Qefalia, numri rendor 15 (pesëmbëdhjetë) z. Fatmir Sezai Xhafaj, numri rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) znj. Klotilda Fatmir Bushka, numri rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) z. Alqi Edmond Bllako, numri rendor 18 (tetëmbëdhjetë) z. Eduard Pajtim Shalsi.

Me vendimin nr. 440, datë 10.09.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vakanca e krijuar nga dorëheqja e znj. Najada Fatosh Çomo është zëvendësuar me znj. Mimi Pjetër Kodheli. Megjithëse, në bazë të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kandidati i rirënditur me numrin më të madh të votave ishte z. Pandeli Sotir Majko, mbështetur në nenin 163, pika 7, të Kodit Zgjedhor, mandati iu dha znj. Kodheli, në zbatim të respektimit të kuotës gjinore të gjinisë së nënpërfaqësuar.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Pandeli Sotir Majko.

Me shkresën nr. 2009 prot., datë 1.4.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Pandeli Sotir Majko, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Pandeli Sotir Majko, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 28 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 2016 prot., datë 4.4.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2017 prot., datë 4.4.2022, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Pandeli Sotir Majko, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Pandeli Sotir Majko.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3942/1 prot., datë 4.4.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Pandeli Sotir Majko, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është i padënuar.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatoj se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Pandeli Sotir Majko, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Alqi Edmond Bllako, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), z. Pandeli Sotir Majko.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2; 163, pika 7; 164, pika 2; të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

VENDOSI:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Pandeli Sotir Majko.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi